



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, më 21 nëntor 2012, në orën 10:00, sala N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Albert Kinolli.

Të ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, z. Fehmi Mujota, Ministër - Ministria e Infrastrukturës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatore; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi, Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.11.2012;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.11.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.11.2012.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Infrastrukturës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Kryetari – Raporti i auditimit për Ministrinë e Infrastrukturës (MI) është i mangët, për shkak të disa kontratave, të cilat nuk kanë mundur të jenë lëndë të auditimit, për arsye se në kohën e Auditimit, të njëjtat lëndë ishin nën hetim nga prokuroria e EULEX-it, bashkë me këtë edhe kontrata e autostradës Merdare – Morinë, si dhe 7 kontrata të tjera që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrugëve.

Ishte i mendimit se MI, pas procesit të përfundimit të hetimeve, do të sigurojë një kopje të këtyre kontratave për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kërkoi sqarim lidhur me vazhdimin e kontratave për mirëmbajtjen e rrugëve me operatorët e njëjtë ekonomik, që dosjet e tyre janë nën hetime tek EULEX-i.

Pyeti: Pse nuk është bërë funksionalizimi i TASK FORCËS, për implementimin e Planit të veprimit, që i raporton ministrit drejtpërdrejt (i cekur në rekomandimin numër 6 të ZAP-it)?

Pse Njësia e Auditimit nuk është fokusuar në fusha që paraqesin rrezik më të lartë, dhe se a është bërë rritja e numrit të auditorëve të brendshëm, ashtu siç ka kërkuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm?

Afrim Hoti – Pyeti: Cilat masa administrative janë marrë ndaj personelit, lidhur me parregullsitë që ka identifikuar ZAP-i në fushën e prokurimit në MI? Çfarë hapash ka ndërmarrë MI, për regjistrimin e tokave që janë pronë e Ministrisë, sipas rekomandimeve të ZAP-it?

Ramiz Lladrovci – Tha se ZAP-i ka dhënë opinionin e vet lidhur me pasqyrat vjetore financiare për vitin 2011, i cili është opinion i pakualifikuar në theksim të çështjes se është një opinion i mirë. Kjo për faktin se MI ka një buxhet mbi 288 milionë euro dhe është e kuptueshme që mund të ketë edhe lëshime të vogla teknike, si rezultat i ngarkesave në punë. Shpresoj që në vitin tjetër këto të gjetura do të tejkalohen.

Mursel Haljilji – Ishte i mendimit se Raporti i ZAP-it ka të dhëna të mjaftueshme sa i përket të gjeturave në MI, kur dihet fakti se një pjesë e lëndëve nuk është audituar nga ZAP-i, për shkak të rrethanave të krijuara në këtë Ministri. Pyeti: Çka ka ndodhur me ato projekte, sepse ne si Komision duhet të kemi ndonjë informacion lidhur me këto projekte që nuk janë audituar?

Në çështjen e prokurimit ka shkelje, për shkak se mbi 40% e punëve u janë lënë që t'i kryejnë subkontraktorët, e që mendoj se kjo përben një shkelje të Ligjit të prokurimit.

Po ashtu, ka raste që tenderin e kanë fituar kompanitë që kanë pasur çmime më të larta, sesa firmat tjera konkurruese, që kanë pasur çmime më të ulëta, por nuk kanë mundur të fitojnë tenderin. Pyeti: A ka pasur ankesa nga kompanitë, që nuk e kanë fituar tenderin, edhe pse çmimet e tyre kanë qenë më të ulëta?

Armend Zemaj –Kjo Ministri, sipas ndarjes buxhetore është njëra nga institucionet që për vitin 2011 ka shpenzuar një shumë mbi 276 milionë buxhet dhe një pjesë e konsideruar e këtij shpenzimi nuk është audituar nga ZAP-i. Pra, nuk është audituar pjesa më e madhe e shpenzimeve, si autostrada që është afër 40% e mjeteve, që ndahen për projektet e zhvillimit ekonomik. Çështje tjetër është pagesa e punëtorëve, të cilët edhe pse nuk kanë pasur kontrata të rregullta të punës, ata janë paguar. MI edhe në vitin 2011, ka pasur mangësi në menaxhimin e buxhetit në pjesën e menaxhimit të projekteve nga programi: “Bashkëfinancimi me kuvendet komunale”. Po ashtu, është mirë që auditori në raport të paraqesë edhe kompanitë fituese të këtyre projekteve, p.sh. për rrugën Llukac – Tomoc – Kovragë, ku është fituar tenderi, mirëpo mbi 40% e punëve janë lënë të kryhen subkontraktori, që është një shkelje e Ligjit të prokurimit. Situata e ngjashme është edhe me rrugën Rogan– Hogosht, ku operatori ekonomik nuk i ka kryer punët sipas marrëveshjes. Po ashtu, edhe në projektet e sinjalizimit në rrugë ka lëshime të natyrës së ngjashme. Nuk duhet të shkohet në praktika të auditimit të një shume të

vogël të buxhetit, sikurse në rastin e kësaj Ministrie, por të kihet parasysh ndarja e buxhetit, sepse një auditim i një shume të vogël, asnjëherë nuk pasqyron gjendjen reale. Mendoj se në raportet e ardhshme, ZAP-i duhet të ketë për bazë këtë element.

Adem Grabovci – Raporti i auditimit është pasqyrë reale e gjendjes në këtë Ministri. Vërejtjet dhe kritikët e auditorit, ministri duhet t'i ketë parasysh dhe të merren seriozisht. Në specifikat e projekteve është vështirë gjithëherë të përzgjidhet kompania fituese, e cila ka çmimin më të lirë, për shkak të natyrës së projekteve. Ministri do të merret shumë seriozisht edhe me çështjen e regjistrimit të pasurisë, si dhe me të gjeturat brenda administratës së kësaj Ministrie.

Bali Muharremaj- Ngriti shqetësimin lidhur me të gjeturat: MI ka paguar punëtorë, shoferë dhe instruktorë, pa kontrata valide të punës (instructorët të cilët nuk kishin kaluar testin e licencës). Raportet jocomplete për shfrytëzimin e veturave zyrtare tek Ministria e Infrastrukturës. Mosfunksionimi i mirë i Komitetit të Auditimit, ku gjatë vitit 2011 është mbajtur vetëm një takim. Kërkoj sqarim lidhur me këto të gjetura.

Valbona Dibra – Për situatën e menaxhimit të kësaj Ministrie më së miri flet Raporti i auditimit për këtë Ministri, për vetë faktin se ZAP-i ka dhënë një opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, përveç regjistrimit të pasurisë fikse, e cila nuk ndikon në devijimin e opinionit për pasqyrat financiare. Është bërë një punë e madhe në ngritjen e infrastrukturës rrugore në tërë territorin e Kosovës dhe për këtë përgëzoj ministrin, pra për të arriturat në këtë fushë.

Lage Olofson- ZAP- Tha se janë dy çështje të rëndësishme të ngritura në raportet e ZAP-it: njëra ka të bëjë me pasqyrat financiare dhe e dyta me monitorimin e projekteve kapitale. Rekomandimi i përgjithshëm i ZAP-it ka të bëjë me kontrollin e menaxhimit, që është një sfidë për vetë menaxhmentin e MI-së.

Ekziston një zbrazëturë në MI, në aspektin e menaxhimit, në krahasim me atë që Qeveria është duke kërkuar. Rekomandimi i përgjithshëm ka qenë se ministri të rishikojë linjat e llogaridhënies në tërë Ministrinë, ashtu siç kërkohet me rregullat e Ministrisë së Financave. Pastaj, në fushën e prokurimit ekziston një nevojë e madhe, duke filluar nga fillimi deri në fund të procesit, se kush është përgjegjës dhe për çfarë në MI, pse nuk funksionon si duhet tërë zinxhiri. Mekanizimi i Sigurisë, Komiteti i Auditimit dhe Njësia e Auditimit nuk janë të funksionalizuara sa duhet.

Fehmi Mujota, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës- Ministria ka 7 departamente, të cilat përpiqen që të vazhdojnë punën për krijimin e një mjedisi jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, me vizionin që ka përcaktuar Qeveria dhe që aspiron një modernizim dhe zhvillim të infrastrukturës rrugore, por edhe në fusha të tjera. Deri në përfundim të vitit 2011, përveç projekteve kapitale të realizuara, janë përfunduar rreth 1200 km rrugë të asfaltuara dhe ka vënë në funksion kryesisht 280 km të hekurudhës nga 334 sa ka Republika e Kosovës, në standardin dhe kushtet që ka Republika e Kosovës - ky është një proces që vazhdon tutje. Është përfunduar me sukses koncesionimi i Aeroportit Ndërkombëtar, ndërsa tash kemi një realitet të ri të krijuar në këtë fushë, pra të rritja e numrit të pasagjerëve dhe të cilësia e shërbimeve. Ky aeroport është një dëshmi se jemi në rrugë të mbarë që t'i realizojmë projektet madhore për ekonominë e vendit. Rruga e shtatë ose Rruga e Kombit, autostrada Morinë – Merdare, rruga N2 ose rruga Prishtinë – Mitrovicë dhe rruga N9 Prishtinë –Pejë, kanë qenë një sfidë në vetë dhe natyrisht MI mirëpret të gjitha komentet dhe të gjitha adresimet që janë shtruar këtu për të parë suksesin, por edhe vështirësitë e kësaj Ministrie gjatë këtyre proceseve.

Fokusimi i Ministrisë gjatë vitit 2011 dhe 2012, është në dokumentin referues të menaxhimit dhe të kontrollit të financave. Është objektiv i Ministrisë që të përmbush kërkesat e parapara me këtë ligj. Pasqyrat financiare për vitin 2011 janë përgatitur me kohë. Çmojmë punën e ZAP-it në MI, e cila vërteton në masë të madhe rregullsinë në lidhje me udhëheqjen dhe

vlerësimin e përgjithshëm të punëve në këtë Ministri dhe kanë mundësuar që të kenë një efekt material dhe një prezantim të drejtë lidhur me shpenzimin e fondeve të Republikës së Kosovës. MI këto vërtetësi i ka pranuar plotësisht dhe të gjitha vërejtjet i ka parë si reale, të drejta, të qëndrueshme dhe që kanë mundësuar të kihet qasje ndryshe në vitin 2012.

Shumë çështje të cilat janë adresuar në raportin e ZAP-it, tashmë janë adresuar gjatë vitit 2012 dhe janë në përmirësim e sipër. Janë ndërmarrë edhe masa administrative ndaj zyrtarëve, të cilat masa do të mundësojnë përmirësimin e gjendjes në menaxhimin financave në këtë Ministri. Në vitin 2011, shpenzimet kanë ndodhur kryesisht në investime kapitale, kryesisht në Rugën e Kombit, por edhe në 46 projekte të tjera. Nuk përjashtohet rasti që ka pasur ndonjë ngecje nga ndonjë operator, që nuk ka realizuar me kohë projektin e duhur dhe me cilësinë e duhur. Përgjegjësitë janë të ndara dhe secili resor ndërmerr masa që të kryhen punët sipas përgjegjësisë. Aktualisht janë 70 projekte në realizim dhe siguroj Komisionin se MI, për të gjitha projektet me bashkëfinancim me komunat, ka pasur një qasje të re në këtë drejtim. Ministria ka marrë kërkesat prej komunave, i ka vlerësuar dhe në bashkëpunim me komunat ka decentralizuar buxhetin. Plotësisht ka dërguar te komunat 16 kontrata në vitin 2012, ku të gjitha procedurat janë udhëhequr nga komunat, ndërsa Ministria është investitori kryesor. Janë vetëm dy raste ku Ministria ka udhëhequr me procedura, është fjala për Komunën e Mamushës dhe një rast në Dragash. Bartja e projekteve nga viti 2012 në vitin 2013, janë me arsye se kontratat janë afatgjata.

Pasqyrat financiare janë punuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Sipas raportit, ka rritje të shpenzimeve për karburant, udhëtime jashtë vendit dhe mirëmbajtjen e veturave. MI ka ngritur buxhetin në masë të madhe të shpenzimeve kapitale dhe kjo detyrimisht reflekton edhe në rritjen e shpenzimeve. Ka pasur udhëtime më tepër jashtë vendit. Fatbardhësisht Ministria e Infrastrukturës merr pjesë në shumicën e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe si rrjedhojë e kësaj edhe ushtrimet për përfaqësim janë shtuar.

Ministria ka përgatitur planin e veprimit për rekomandimet e dala dhe tani ky plan është vënë në funksion. Presim angazhim shtesë për adresimin e të gjitha të gjeturave.

Interesimet e deputetëve janë të drejta, por disa prej tyre tashmë janë tejkaluar. Çështja e mosaduditimit të projekteve të autostradës, nuk është çështje që MI nuk e ka ofruar, por auditori ka vlerësuar kështu sipas ligjit. MI është e gatshme në çdo kohë të ofrojë të dhëna për Komisionin. Për këto ka përgjegjësi ligjore të adresuara, është kompania mbikëqyrëse e cila është e kontraktuar nga Qeveria, janë njerëz profesionistë dhe çdo parregullsi do të jetë e adresuara nga ana e Ministrisë.

Evidentimi i pronave- është ngritur një Komision i veçantë për këtë çështje, por ende nuk e ka sjellë raportin final, sepse ka vështirësi në aspektin kadastral dhe në shumë raste mungojnë të dhënat e sakta. Përfundimisht, MI do të ketë të dhëna të plota lidhur me këtë dhe kjo do të bëhet publike.

Çështja e subvencionimit të transportit humanitar është çështje e ngritur me të drejtë. Kjo çështje duhet të marrë fund, duhet gjetur modalitete të reja, sepse tashmë në Kosovë ka lëvizje të lirë të qytetarëve.

Ankesat e operatorëve ekonomikë në vitin 2012, janë adresuara shumë. Gjendja është legale, operatorët e pakënaqur kanë bërë ankesë, ndërsa OSHP ka vendosur, ku përveç një rasti që e ka kthyer në rishqyrtim, në rastet e tjera ka vlerësuar vendimin e Ministrisë, si të drejtë.

Kontrolli i brendshëm te pagesa e ekzaminerëve, bëhet fjalë për disa zyrtarë, të cilët nuk kanë kaluar testin. Këta njerëz janë risistemuar brenda Ministrisë, konform aftësive të tyre.

Task forca- është bërë plani i veprimit dhe MI është në fazën e konsolidimit të saj, e cila do të përcjellë punën e auditimit në këtë Ministri.

Auditimi i brendshëm, ka qenë i fokusuar në çështjen e ekzaminerëve, dhe me rekomandimin e ministrit dhe të sekretarit, ai tashmë bën auditimin në pajtim me ligjin. Ka nevojë për forcim të kapaciteteve dhe ka nevojë për ndarje të plotë të detyrave, ku në ndonjë rast nuk ka funksionuar plotësisht, ashtu siç ka qenë e paraparë.

Pajtohemi me të gjeturën që nuk kemi arritur synimin tonë, sepse si Ministri, jemi të interesuar që të përmbushim synimin tonë të dëshiruar.

Ministria është në dispozicion për të gjitha interesimet e Komisionit lidhur me të gjeturat e ZAP-it.

Kryetari- Tha se sipas informatave që dha Ministri dhe po ashtu sipas auditimit të ndërmjetëm, Komisioni ka informata se kjo Ministri është në rrugë të mbarë të adresimit të të gjeturave të ZAP-it. Propozoi që MI, deri më 15 dhjetor 2012, të dorëzojë Planin e veprimit, lidhur me të gjitha të gjeturat e ZAP-it.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Të kërkohet nga Ministria e Infrastrukturës, që deri më 15 dhjetor 2012, Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike t`ia paraqesë Planin e Veprimit, lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në këtë Ministri.

4. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se është koha që Kuvendi të fillojë me procedurat e përzgjedhjes së auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it, për vitin 2012.

Kryetari Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kryesisë së Kuvendit t`ia paraqesë këtë

Rekomandim

Të autorizohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që në bashkëpunim me Drejtorinë për Prokurim të Administratës së Kuvendit, të bëjë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm, për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu